

**UDHËZIM**  
**Nr.43, datë 30.10.2009**

**PËR INSTALIMIN E PAJISJEVE FISKALE NË MAGAZINAT DOGANORE DHE  
TATIMORE TË KARBURANTEVE DHE LËSHIMIT TË KUPONIT TATIMOR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, nenit 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, i ndryshuar, Ministri i Financave

**UDHËZON:**

1. Shitja e sasive të karburanteve (të specifikuara sipas llojeve) nga magazinat doganore të subjekteve importuese (pasi këto kanë kryer procedurat e zhdoganimit), kryhet në çdo rast nëpërmjet lëshimit të faturës tatimore, e cila shoqëron sasinë e karburantit të shitur.

2. Sasia e karburantit të dalë evidentohet nëpërmjet matësve të sasisë së dalë, të cilat janë të certifikuara nga Drejtoria e Kalibrimit dhe e Peshëmatjes dhe që kontrollohen në vazhdimësi për funksionimin normal të tyre.

3. Në momentin e daljes nga magazina doganore, sasia e karburantit të shitur, përveç faturës tatimore, shoqërohet detyrimisht edhe me kupon tatimor, i cili lëshohet nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale. Ky kupon i bashkëngjitet faturës tatimore për çdo dalje të karburantit (shitje të tij) dhe e shoqëron faturën tatimore gjatë gjithë lëvizjes (transportit) nga pika e daljes nga magazina doganore, deri në vendin e shkarkimit të karburantit në depozitat e subjektit blerës. Ai mbahet i tillë i bashkëngjitur me faturën tatimore nga blerësi.

4. Kuponi tatimor, i cili do t'i bashkëngjitet faturës tatimore të shitjes, duhet të përmbajë detyrimisht të regjistruara të gjitha të dhënat e kërkuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të dhëna të cilat do t'u jepen për formatim subjekteve të autorizuar nga Ministri i Financave për furnizimin me pajisje fiskale. Këto pajisje instalohen e mirëmbahen vetëm nga këto shoqëritë të autorizuar.

5. Subjektet e shitjes së karburantit nga magazina doganore janë të detyruara të raportojnë periodikisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në përputhje me udhëzimin nr.39, datë 9.12.2008 të Ministrit të Financave, njëloj sikurse subjektet e tjera përdoruese të pajisjeve fiskale.

6. Subjektet transportuese të karburantit pas daljes nga magazina doganore, qofshin këto thjesht subjekte transportuese, në pronësi të subjektit blerës apo shitës, detyrohen të mbajnë të bashkëngjitur me faturën tatimore edhe kuponin tatimor që i përket blerjes së karburantit që po transportohet. Mosparaqitja e këtij të fundit së bashku me faturën në momentin e një kontrolli të mundshëm, i penalizon ato sikurse moslëshimi i faturës, bazuar në nenin 21 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. I njëjti penaltet zbatohet edhe për subjektin transportues, kur ky është subjekt vetëtransportues (i ndryshëm nga shitësi).

7. Kuponi tatimor (pjesë shoqëruese e faturës tatimore) përmban të gjitha elementet e përcaktuara për lëshimin e tij, sidomos sasinë e shitur (të dalë nga magazina doganore), çmimin për njësi pa TVSH, vlerën e TVSH dhe vlerën me TVSH.

8. Kuponi tatimor kontrollohet nga doganieri në pikën e daljes nga magazina doganore. Ky i fundit nuk lejon lëvizjen e karburantit nga magazina doganore (qoftë me mjete transporti, qoftë nëpërmjet lidhjes me tubacion) pa u lëshuar (prerë) kuponin tatimor, krahas lëshimit të faturës tatimore. Çdo lëvizje e karburantit pa lëshimin e kuponit tatimor krahas faturës tatimore, ngarkon me përgjegjësi ligjore dhe penaltete tatimore subjektin shitës, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi administrative, sipas kuadrit ligjor në fuqi punonjësin e doganës në vendin e daljes së karburantit nga magazina doganore, nëse ai nuk kontrollon lëshimin e kuponit.

9. Procedurat e pajisjes me dokumentacionin e përcaktuar më lart, për rastet e daljeve nga magazinat doganore, detyrohen të zbatohen edhe nga shoqëria “ARMO” sh.a. për daljet e karburanteve nga magazina tatimore.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet strukturave të tyre, kryejnë kontrolle të vazhdueshme e të përbashkëta, për zbatimin me korrektësi të këtij udhëzimi. Për zbatimin me korrektësi të këtij udhëzimi, ato vënë në dijeni subjektet që disponojnë magazina doganore për karburantin, dhe subjektin sipas pikës 9 të këtij udhëzimi, si dhe udhëzojnë punonjësit që ngarkohen me kontrollin e zbatimit të detyrave që dalin nga ky udhëzim.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

**Ridvan Bode**